

PROCESVERBAL
nga mbledhja e 35-të e Këshillit të Agjencisë për
Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale,
të mbajtur më datë 16.09.2022

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes konferenciare:
Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMAA, Selver Ajdini zëvendëskryetar i Këshillit të ASHMAA, m-r Alma Mashoviq, d-r Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarë të Këshillit të Agjencisë që mungojnë: /

Në mbledhje, përmes lidhjes konferenciare ishte i pranishëm edhe d-r Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm përmes lidhjes konferenciare, nga Shërbimi profesional ishin:
Cvetanka Mitrevska, m-r Emilija Janevska, Goran Radunoviq, Maja Damevska.

Të pranishëm të tjerë: /

Z. Petrushevski e hapi Mbledhjen e 35-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u realizua përmes lidhjes video konferenciare.

Këshilli i Agjencisë njëzëri (për shkaqe teknike, votimi i z. Ajdini u shpreh përmes audio lidhjes) u miratua si vijon:

REND DITE

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga mbledhja e 34-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më datë 06.09.2022
2. Propozim-vendim për rritjen e planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022.
3. Propozim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj Shoqërisë Tregtare të Radiodifuzionit KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 14 nga Ligji për media.
4. Propozim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj Shoqërisë Tregtare të Radiodifuzionit KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 50 paragrafi 3 nga LSHMAA.
5. Propozim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj Shoqërisë Tregtare të Radiodifuzionit KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 53 paragrafi 2 nga LSHMAA.
6. Propozim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj Shoqërisë Tregtare të Radiodifuzionit TV SHENJA SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 98 paragrafi 2 nga LSHMAA
7. Propozim për dhënien e lejes për realizimin e procedurës së furnizimit publik për shërbimin e furnizimit publik si vijon: Shërbime të instalimit të ujit dhe rrymës.

8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi dhe njëzëri e miratoi Procesverbalin e seancës së 34-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 06.09.2022, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski e arsyetoi Propozim-vendimin për rritjen e planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022. Sqaroi se nevojitet të rritet plani financiar sepse për momentin nuk ka mundësi që të sigurohen mjete nga zëra tjerë që mund të ulen ose transferohen për blerje të energjisë elektrike. Për këtë arsye udhëheqësi i Sektorit për Financa dhe Logjistikë propozoi rritje të Planit Financiar. Në fund të vitit sigurisht se do të ketë kursime të caktuara dhe realisht nuk do të rritet Plani Financiar, por për momentin pasi që kemi furnizime publike, që ende duhet të realizohen dhe të merren para nga mjetet e akumuluar nga vitet e kaluara. Në këtë drejtim sqaroi se në javën e ardhshme duhet të bëhet edhe ndryshim i Planit për furnizime publike për blerje të energjisë elektrike.

Udhëheqësi i Sektorit për Financa dhe Logjistikë Goran Radunović sqaroi se propozohet rritja e Planit Financiar për 10 milion denarë dhe me këtë do të bëhet 143.754.238,00 denarë, ndërsa mjetet do të shfrytëzohen për blerjen e energjisë elektrike. Si shembull e potencoi llogarinë për energji elektronike për muajin e 7-të që ishte për shtatë herë më e lartë se sa ajo e muajit të 6-të. Gjithashtu theksoi se tani gjatë furnizimeve më nuk negociohet për çmimin e energjisë elektrike sepse ajo është e përcaktuar sipas çmimit në bursë botërore, respektivisht se tani negociohet vetëm shuma e marzhës ndaj atij që do të furnizojë me energji elektrike, me atë se ligjëvendësi e ka kufizuar dhe nuk mund të jetë me e lartë se 10%. Të gjitha këto para janë të dedikuara për të shpallur një furnizim të ri dhe për të paguar mjetet e energjisë së shpenzuar elektrike deri në fund të vitit.

Z. Fidanoski tha se të gjithë janë të ballafaquar me krizën, respektivisht problemet rreth furnizimit dhe konsumit të energjisë elektrike. Ajo është e dukshme edhe nga llogaritë e rritura madje edhe te institucionet e që paraqet një problem global. Tha se nuk dyshon në vlerësimin, por prapë se prapë nuk mund të planifikohet prej tani për në janar të vitit 2023 se si do të lëviz shuma e llogarive andaj nuk nevojitet që të bëhet edhe një rebalanc. Pyeti se nëse mendohet të bëhet një kursim i përbashkët me subjektin që gjendet në të njëjtën ndërtesë me ASHMAA, me Agjencinë për Rini dhe Sport, të ndërpritet njëri prej ashensorëve për të pasur shpenzime më të vogla. Pastaj me kalimin e kohës ndoshta duhet të ndërmerren edhe masa të tjera që do të jenë të domosdoshme në kontekst të ballafaqimit me këtë sfidë për kursimin e energjisë elektrike. Në fund u prononcua se do të japë përkrahje për propozimin për rritje të Planit Financiar.

Z. Trajçevski sqaroi se udhëheqësi Radunović ka arsyetuar se këto mjete nuk janë deri në fund të këtij viti, por për një periudhë njëvjeçare deri në harxhimin e mjeteve. Llogaria për energji elektrik arrin në nivel mujor, për muajin korrik është 600 mijë denarë për të cilat ASHMAA paguan 70%, ndërsa Agjencia për Rini dhe Sport 30%. Sqaroi se këto mjete me të cilat rritet plani, janë planifikuar për 12 muaj dhe shpreson se do të mbulohet rryma me këtë shumë. Informoi se me Agjencinë për Rini dhe Sport veç më është biseduar, në katin e 8-të

është ç'kyçur ftohja, rryma është ç'kyçur gjithashtu dhe nuk shfrytëzohet në të gjitha korridoret e ndërtesës. Më pas udhëheqësi Radunoviq në koordinim me kompaninë që e mirëmban sistemin e ngrohjes dhe ftohjes, e kanë rregulluar që të jetë në sezone të ftohjes, pra temperatura e kondicionerëve të mos jetë me e ulët se 27 shkallë, ndërsa në sezonin e ngrohjes më e lartë se 20 gradë. Theksoi se disa ditë me radhë kondicionerët aspak nuk shfrytëzohen, ndërsa për shkak të ftohjes, me gjasë ato më tutje nuk do të shfrytëzohen. Tani do të shihet rezultati me llogarinë e gushtit, por pasqyrë më reale do të kemi në tetor kur do të merret llogaria për shtatorin, sepse atëherë gjatë tërë muajit do të kursehet dhe kështu do të shihen efektet e masave të ndërmarra nga aspekti i kursimit të energjisë elektrike.

Z. Petrushevski tha se propozimi për rritjen e Planit Financiar gjithsesi se do të përkrahet sepse nuk ka tjetër zgjidhje. Sqaroi se gjatë muajve të kaluar, disa herë jo zyrtarisht ka komunikuar me z.Trajçevskin për këtë temë. Aktivitetet e ndërmarra për kursimin e energjisë elektrike në ASHMAA janë masa të domosdoshme dhe besohet se edhe shërbimi dhe drejtori janë shumë profesional në këtë drejtim dhe llogaritet se do të ketë efekt të madh. Në lidhje me rekomandimet e Qeverisë që janë miratuar këtë verë për t'u rritur parametrat për amvisëritë dhe subjektet juridike, tha se Agjencia rrjedhimisht si subjekt juridik ka të drejtë të instalojë panele diellore, fotovoltik me kapacitet deri në 40 kilovatë, në tarracën ose kulmin e ndërtesës. Sqaroi se nuk kanë bërë përllogaritje se sa do të jetë ajo në nivel vjetor, por sigurisë se do të jetë një kursim i konsiderueshëm. Është mirë që të bëhet përllogaritje se sa këto 40 kilovatë potencial gjatë një viti mesatar diellor do të prodhonin dhe se sa ka kjo vlerë në para. Por, tha se situata është pak e komplikuar sepse nuk është vetëm ASHMAA pronar, ka edhe 30% një subjekt tjetër, Agjencia për Rini dhe Sport dhe momenti i dytë është konfigurimi më pak i volitshëm i kulmit të ndërtesës sepse është objekt oval që arrihet vështirë. Sidoqoftë para se të fillohet me çfarëdo projekti, fillimisht duhet të bëhet konstruksion financiar në aspekt të rëndësisë së këtyre 40 kilovateve, e më pas të bisedohet me Agjencinë për Rini dhe Sport nëse kanë interesim dhe edhe pse anëtarët e Këshillit dhe drejtori në njëfarë mënyre janë në largim, prapë se prapë konsiderohet se është mirë që kushto që vjen pas tyre të kenë një projekt dhe nëse mund të përfundohet, duke konsideruar se 40 kilovat mund të kontribuojnë në aspekt financiar. Sqaroi se kanë bërë përllogaritje dhe sipas tij investimi nuk është shumë i madh, bëhet fjalë për rreth 30-40 mijë euro për t'u instaluar, sipas çmimeve të fundit të tregut. Sqaroi se 40 kilovatë nuk është energji e vogël, me që dihet se konsumatorët kryesor në Agjenci janë salla e serverëve dhe ftohja dhe ngrohja, varësisht nga stinët e vitit. Nëse përmbushen këto konsumatorë dhe plus ka opsion kur nuk punohet gjatë vikendit, rryma të kthehet, respektivisht të shitet në sistem, mendojmë se vlen të bëhen përpjekje që drejtori të japë urdhër për Sektorin e Teknologjive që të bëjnë analizë që të mos paguhet panevojshëm për ekspert të kësaj fushe dhe më pas Sektori i Financave të bëjë një përllogaritje se çfarë rëndësie kanë këto 40 kilovatë në nivel vjetor.

Z. Trajçev në lidhje me diskutimin e z. Petrushevski tha se shpreh përkrahje për propozimin. Konsideron se në këtë situatë krize me të cilën ballafaqohet e tërë Evropa, një investim i këtyre do të kontribuojë për uljen e shpenzimeve dhe nëse bëhet matematikë për investimin dhe përfitimin për vitet e ardhshme, ajo mund të përllogaritet thjeshtë me çmimin e rrymës për kilovat, se sa do të jetë kursimi dhe në çfarë periudhe do të kthehet investimi. Konsideron se duhet të bëhet një analizë e tillë në kuadër të Agjencisë dhe supozon se të gjithë do ta përkrahin atë. Pritshmëritë janë se kjo krizë me energjinë elektrike nuk do të jenë vetëm gjatë këtij viti, por do të vazhdojë edhe më tutje. U prononcuar se do të japë përkrahje të plotë për këtë propozim dhe normalisht ASHMAA në kuadër të kapaciteteve të veta të bëjë një analizë për t'u parë periudha e kthimit të atij investimi ku edhe përkundër llogarisë, edhe

më tutje të vazhdohet me në procedurë të atillë të kursimit. Në lidhje me kursimin e energjisë elektrike tha se gjithashtu duhet të mendohet për punën eventuale nga shtëpia, për një periudhë të caktuar, veçanërisht në periudhën e dimrit kur temperaturat janë më të ultë dhe kur nevojitet energji më e madhe për ngrohjen e hapësirave. Propozoi që drejtori të mendojë ndonjë organizim të atillë që të gjitha punët që mund të kryhen nga shtëpia, veçanërisht që sot teknologjia jep mundësi të këtyllë, takime online, sikur që mbahet tani seanca p.sh, ndërsa efekti është i njëjtë. Atje ku është e domosdoshme të ketë prani fizike, por aty ku nuk është edhe aq e domosdoshme dhe ku mund të kryhet puna edhe nga shtëpia, të bëhet një plan dhe në këtë mënyrë të bëhen kursime, sepse kjo është një problem serioz ku këto probleme pritet që të rriten veçanërisht gjatë dimrit, jo vetëm me çmimin por edhe me mungesën e mundshme të energjisë elektrike sepse mungesa e energjisë është e madhe edhe në tërë Evropën. Si shembull theksoi se në Zvicër përgatitet një ligj ku nuk guxon askush, madje as në shtëpi të ketë temperaturë më të lartë se 19 gradë dhe do të ketë dënime, për çka shteti do të bëjë kontrollë. Kjo nënkupton se shtete serioze dhe më të forta financiarisht se shteti jonë, veç më ndërmer masa sepse pritshmëritë janë të qarta se do të kemi dimër të vështirë dhe konsiderohet se duhet të bëhet një plan dhe analizë e atillë për kursime maksimale ku të punësuarit nuk duhet patjetër të vijnë në hapësirat e Agjencisë, të punojnë nga shtëpia duke kursyer kështu energjinë elektrike.

Z. Fidanoski u pajtua me faktin që ka probleme dhe pasiguri me shumë shtete në Evropë se çfarë do të ndodhë, sepse nuk ka furnizime të vazhdueshme me energjensë, siç kishte deri më tani. Në kontekst të asaj që e ka thënë z. Trajçev, tha se Agjencia si institucion veç më ka përvojë me punën nga shtëpia gjatë pandemisë së Kovidit dhe sipas tij ajo ka funksionuar shumë mirë, por le të vlerësohet nga drejtori Trajçevski se kur është kjo e nevojshme dhe se si të realizohet. Ata të punësuar që detyrimisht duhet të vijnë në Agjenci për shkak të funksionimit normal të sistemit të jenë sipas mundësisë të vendosur së bashku në një hapësirë në mënyrë që të kursehet energjia elektrike. Besohet se do të gjendet baraspesha më e mirë për mënyrën e funksionimit të sistemit dhe institucionit, duke mos pasur shpenzime të mëdha. Si digresion i diskutimit të z. Petrushevski, tha se Qeveria nuk ka lejuar rritjen e prodhimit maksimal për personat juridik dhe fizik, por e ka lehtësuar procedurën për mundësinë e vendosjes. Sipas vlerësimit të tij, diku rreth 40 kilovatë ose 50 panele janë të nevojshme që të instalohen prej atyre që aktualisht shiten në tregun maqedonas, për të fituar atë prodhimtari të 40 kilovateve. Prej 300 ditëve me diell siç vlerësojnë ekspertët, Maqedonia është vend ideal për zhvillimin e prodhimit. Tha se do të japë përkrahje të plotë nëse fillohet me këtë fazë. Supozohet se do të jetë ashtu duke marrë parasysh çmimet aktuale në bursë për këtë lloj të energjensëve, që relativisht shpejtë shpaguhet edhe pse vlerësimet e mëparshme shpreheshin se ajo duhet të bëhet pas shumë viteve, vlerësuar sipas çmimeve të mëparshme. Tha se panelet duhet të instalohen në anët më me diell të objektit ku rrezon dielli në pjesën më të madhe të ditës. Beson se nëse fillohet me këtë projekt do të ketë përfitime.

Z. Petrushevski tha se ato vende janë në kulmet dhe tarracat e ndërtesës, por prapë se prapë duhet një profesionist për të vlerësuar atë si dhe për kapacitetin dhe qasjen e objektit. Sipas nevojës mund të paguhet edhe një studim profesional që me gjasë nuk do të kushtoj shumë para.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin lejohet rritja e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022, nr. 05-3096/1 nga data 09.08.2022.

Me rritjen e propozuar të Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022, të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara në total do të rriten për 10.000.000,00 denarë, respektivisht do të jenë 143.754.238,00 denarë.

Me rritjen e propozuar do të sigurohen mjetet financiare në shumë të përgjithshme prej 10.000.000,00 denarë, që do të dedikohen për pagesën e shpenzimit të energjisë elektrike sipas kontratës ekzistuese, si dhe për furnizim të ri publik dhe një kontratë të re të cilën Agjencia do ta shpallë në vitin 2022, sepse kontrata e vjetër pritet që të shpenzohet në tërësi.

Me rritjen e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022 do të bëhen ndryshime në këto pozita:

- Të hyrat e përgjithshme rriten për 10.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së deritanishme prej 133.754.238,00 denarë, do të jenë 143.754.238,00 denarë.
- Zëri i të hyrave të tepicës së mjeteve të Transferuara nga viti i kaluar rritet për 10.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së deritanishme prej 49.154.238,00 denarë, do të jenë 59.154.238,00 denarë
- Shpenzimet e përgjithshme rriten për 10.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së deritanishme prej 133.754.238,00 denarë, do të jenë 143.754.238,00 denarë
- Zëri 401 – Energjia e shpenzuar rritet për 10.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së deritanishme prej 3.500.000,00 denarë, do të jenë 13.500.000,00 denarë.
- Pozita 401000 – Energjia e shpenzuar elektrike rritet për 10.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së deritanishme prej 3.000.000,00 denarë, do të jenë 13.000.000,00 denarë

Sektori për Koordinimin dhe Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit të Agjencisë, duhet ta publikojë Vendimin e lartpërmendur në ueb faqen e Agjencisë.

Pikat 3, 4 dhe 5

Z. Petrushevski kërkoi informatë nëse masat e propozuara të vërejtjes publike ndaj SHTR KOMPANI 31-M SHPKNJP Shkup janë të konstatuara nga i njëjti raport?

Z. Trajçevski tha se udhëheqësja Janevska do t'i arsyetojë të gjitha pikat edhe pse bëhet për shkelje të ndryshme, e më pas mund të ketë diskutim për secilën pikë në veçanti.

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore m-r Emilija Janevska sqaroi se raportet janë të ndryshme, por mund të shpjegohen me një arsyetim. Theksoi se të gjitha raportet janë nga mbikëqyrja e rregullt programore dhe administrative që u zhvillua ndaj katër televizioneve në nivel kombëtar që emetojnë program përmes operatorit të rrjeteve publike të komunikimit. Me këtë mbikëqyrje të realizuar në gusht në TV 21-M ishin konstatuar tri shkelje. Shkelja e parë ka të bëjë me Ligjin për media, në nenin 14, respektivisht obligimin e publikimit të impresumit. Në ditën kur është bërë mbikëqyrja është konstatuar se te ky radiodifuzer më 5 gusht 2022, në një pjesë të programeve të emetuara nuk janë publikuar të dhënat që është obligim të emetohen në vend adekuat për secilën përmbajtje të shërbimit programor në emisionin informativ argëtues të mëngjesit. Së këndejmë propozohet që të shqiptohet masa e vërejtjes publike me afat prej 45 ditëve për përshtatje, nga dita e pranimit të aktvendimit e më pas të bëhet edhe një mbikëqyrje kontrolluese. Shkelja e radhës është ndaj nenit 50 paragrafi 3 të LSHMAA, respektivisht rregullave për të miturit. Me mbikëqyrjen është konstatuar se

premierat dhe reprizat e serialeve artistike „Fatih Harbiye“ dhe „Benim adim Melek“, si dhe njoftimet promovuese për emetimin e tyre, ishin të klasifikuara në mënyrë joadekuate dhe të shënuara si program i kategorisë së parë, në vend të asaj si program të kategorisë së dytë, që nuk rekomandohet për fëmijë nën moshën 8 vjeçare, respektivisht për të cilën rekomandohet mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit. Së këndejmë propozohet që të shqiptohet masa e vërejtjes publike me afat prej 30 ditëve për përshtatje, nga dita e pranimit të aktvendimit e më pas të bëhet edhe një mbikëqyrje kontrolluese. Në lidhje me shkeljen e tretë të nenit 53 paragrafi 2 nga LSHMAA tha se ka të bëjë me ndalesën për emetimin e komunikimeve të fshehta komerciale audiovizuale. Është konstatuar se në tërësitë audiovizuale në kuadër të tri edicioneve të ndryshme të emisionit argëtues-informativ „Në focus (Бо фокус)“ ishte emetuar një material i njëjtë për „Bushi resort & spa Skopje“ me nxitje të drejtpërdrejtë për të blerë shërbimet e tyre, që paraqet komunikim të fshehtë komercial audiovizuel. Edhe për këtë shkelje propozohet shqiptimi i masës vërejtje publike me afat për përshtatje sipas Udhëzimit, menjëherë nga dita e pranimit të aktvendimit, që të harmonizohet me Ligj, e më pas të bëhet mbikëqyrje kontrolluese. Sqaroi se radiodifuzeri pas pranimit të tre raporteve menjëherë parashtroi shkresë që është gjithashtu i dorëzuar me materialet, në të cilin thuhet se i pranon raportet në tërësi dhe se janë marrë masa për mënjanimin e dobësive. Z. Ajdini tha se kjo është mirë që radiodifuzeri është prononcuar në bazë të tri shkeljeve dhe se i pranon raportet e Agjencisë, duke vepruar në tërësi sipas masave të shqiptuara. Në materiale thuhet se radiodifuzeri e ka përshtatur punën sipas Ligjit për media dhe LSHMAA. U prononcua se do të votojë për të gjitha tre propozimet për shqiptimin e vërejtjes publike.

votimi për Pikën 3

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar të rregullt programore, nr. 10-3267/1 nga data 26.08.2022 dhe njëzëri konstatoi që ndaj SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup t'i shqiptoj masën e vërejtjes publike për shkeljen e nenit 14 paragrafi 3 nga Ligji për media sepse më datë 5 gusht 2022, në një pjesë të programeve të emetuara nuk i ka publikuar të dhënat për të cilat obligohet t'i emetojnë në vend adekuat për secilën përmbajtje të shërbimit programor.

Këshilli i Agjencisë solli Aktvendim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup dhe në pajtim me Pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afateve për veprim ndaj aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa nr.01-6039/1 nga data 20.10.2015, e obligoi që në afat prej 45 ditëve nga dita e pranimit të Aktvendimit ta harmonizojë punën e vet me dispozitat e Ligjit për media.

Spektori për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike duhet ta përgatis Aktvendimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj radiodifuzerit të theksuar.

Spektori për Çështje Programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të realizojë një mbikëqyrje kontrolluese me qëllim që të përcaktohet nëse subjekti i mbikëqyrur (radiodifuzeri) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (në tërësi, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, ta publikojë të lartpërmendurën në ueb faqen e Agjencisë.

votimi për Pikën 4

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar të rregullt programore, nr. 10-3261/1 nga data 26.08.2022 dhe njëzëri konstatoi që ndaj SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup t'i shqiptoj masën e vërejtjes publike për shkeljen e nenit 50 paragrafi 3 nga LSHMAA dhe të nenit 17 nga Rregullorja për mbrojtjen e të miturve, sepse më datë 5 gusht 2022, në premierë dhe reprizë të episodeve të serialeve artistike Fatih Harbiye“ и „Benim adim Melek“, si dhe njoftimet promovuese për emetimin e saj, ishin të klasifikuara në mënyrë joadekuate dhe të shënuara si programe të kategorisë së parë, në vend të programit të kategorisë së sytë, që nuk rekomandohet për fëmijë nën moshën 8 vjeçare, respektivisht për të cilat rekomandohet mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit.

Në pajtim me Pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afateve për veprim ndaj aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa nr. 01-6039/1 nga data 20.10.2015, ndaj SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup duke e urdhëruar që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të Aktvendimit për shqiptimin e masës së vërejtjes publike, ta përshtatë punën e vet sipas dispozitave të LSHMAA dhe Rregullorja për mbrojtjen e të miturve.

Spektori për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike duhet ta përgatis Aktvendimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj radiodifuzerit të theksuar.

Spektori për Çështje Programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të realizojë një mbikëqyrje kontrolluese me qëllim që të përcaktohet nëse subjekti i mbikëqyrur (radiodifuzeri) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (në tërësi, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, ta publikojë të lartpërmendurën në ueb faqen e Agjencisë.

votimi për Pikën 5

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar të rregullt programore, nr. 10-3262/1 nga data 26.08.2022 dhe njëzëri konstatoi që ndaj SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup t'i shqiptoj masën e vërejtjes publike për shkeljen e nenit 53 paragrafi 2 nga LSHMAA, sepse më datë 5 gusht 2022, në kuadër të tri edicioneve të ndryshme të emisionit argëtues-informativ „Në fokus (Bo fokus)“ ishte emetuar një material i njëjtë për „Bushi resort & spa Skopje“ me nxitje të drejtpërdrejtë për të blerë shërbimet e tyre, që paraqet komunikim të fshehtë komercial audiovizuel.

Në pajtim me Pikën 4 të Udhëzimit për përcaktimin e afateve për veprim ndaj aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa (tekst i spastruar) nr. 01-6039/1 nga data 20.10.2015, e urdhëroi që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit, ta përshtatë punën e vet sipas dispozitave të LSHMAA.

Spektori për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike duhet ta përgatis Aktvendimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj radiodifuzerit të theksuar.

Spektori për Çështje Programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të realizojë një mbikëqyrje kontrolluese me qëllim që të përcaktohet nëse subjekti i mbikëqyrur (radiodifuzeri) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (në tërësi, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, ta publikojë të lartpërmendurën në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 6

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore m-r Emilija Janevska e sqaroi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj Shoqërisë Tregtare të Radiodifuzionit TV SHENJA SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 98 paragrafi 2 të LSHMAA. Sqaroi se shkeljet janë konstatuar me të njëjtën mbikëqyrje programore dhe administrative, të realizuar në gusht. Në pajtim me Rregulloren për teknikat e reja reklamuese me qëllim të mos priset integriteti i veprave audiovizuele dhe të mos preket kënaqësia e qytetarëve nga shikimi i programeve është konstatuar se në emisionin "SOFRA" janë emetuar pop-ap/reklama në ekran që nuk tejkalojnë në periudhën e përcaktuar prej së paku 15 minutave. Për radiodifuzerin propozohet masa e vërejtjes publike me afat prej 15 ditëve për përshtatje, pas pranimit të aktvendimit, e më pas të bëhet edhe një mbikëqyrje kontrolluese.

Z. Ajdini pyeti nëse është prononcuar radiodifuzeri për këto shkelje sepse në materiale nuk është dorëzuar një dokument i atillë.

Udhëheqësja Janevska sqaroi se nuk ka arritur prononcim nga ana e TV Shenja edhe pse sipas Ligjit u është dorëzuar raporti dhe kërkesa për prononcim në bazë të kësaj shkelje të konstatuar.

Z. Trajçevski informoi se pas publikimit të raportit në ueb faqen e Agjencisë, drejtori i televizionit i është lajmëruar përmes telefonit duke sqaruar se do ta përmirësojnë shkeljen, por që për këtë nuk ka kurrfarë dokumenti, andaj edhe nuk ka materiale për këtë seancë.

Z. Ajdini tha se kjo që është lajmëruar me telefon është mirë sepse në njëfarë mënyre ai e pranon shkeljen.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar programore, nr. 10-3263/1 nga data 26.08.2022 dhe njëzëri vendosi që ndaj SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup t'i shqiptohet masa e vërejtjes publike për shkeljen e nenit 98 paragrafi 2 nga LSHMAA dhe të nenit 14 paragrafi 4 nga Rregullorja për teknikat e reja reklamuese sepse më datë 10 gusht 2022 në emisionin "SOFRA" ishin emetuar pop-ap/reklama në ekran të ndarë që nuk tejkalojnë në periudhën e përcaktuar prej së paku 15 minutave.

Në pajtim me Pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afateve për veprim ndaj aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa (tekst i spastruar) nr. 01-6039/1 nga data 20.10.2015, e urdhëroi që në afat prej 15 ditëve nga pranimi i Aktvendimit, ta përshtatë punën e vet sipas dispozitave të LSHMAA dhe Rregullores për teknikat e reja reklamuese.

Sektori për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike duhet ta përgatis Aktvendimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj radiodifuzerit të theksuar.

Sektori për Çështje Programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të realizojë një mbikëqyrje kontrolluese me qëllim që të përcaktohet nëse subjekti i mbikëqyruar (radiodifuzeri) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (në tërësi, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, ta publikojë të lartpërmendurën në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 7

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike Cvetanka Mitrevska, e arsyetoi Propozimin për dhënien e lejes për realizimin e procedurës së furnizimit publik për këtë lëndë të shërbimit të furnizimit publik: Shërbime të instalimit të ujit dhe rrymës. Sqaroi se ky furnizim zbatohet çdo vit ndërsa ajo do të zbatohet si furnizim me vlerë të vogël. Shpallja do të publikohet në sistemin elektronik të furnizimeve publike ndërsa të gjitha të dhënat si dhe mënyra e realizimit të furnizimit, afati, kriteret dhe të dhënat e tjera janë në materialet e parashtruara.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi realizimin e procedurës për furnizim publik – shërbime: shërbime të instalimit të ujit dhe rrymës.

Realizimi i procedurës së furnizimit publik për lëndën e shërbimit të furnizimit publik: Shërbime të instalimit të ujit dhe rrymës është e paraparë dhe është në pajtim me Planin vjetor të furnizimeve publike për vitin 2022 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (teksti i spastruar) nr. 05-563/2 nga data 08.02.2022, ndërsa mjetet janë siguruar me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022.

Pika 8

Të ndryshme

Në këtë pikë nuk kishte diskutim.

**Nr. 02-3436/8
29.09.2022**

Shkup

**Agjencia për shërbime mediatike
audio dhe audiovizuale
Kryetar i Këshillit,
Llazo PETRUSHEVSKI, d.v**